

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Krasniqi: Ndryshimet në ligjin për Specialen nuk e rrëzojnë vetvetiu aktgjykimin
ADRESA	https://albeu.com/kosove/krasniqi-ndryshimet-ne-ligjin-per-specialen-nuk-e-rrrezojne-vetvetiu-aktgjykimin/1032106/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHË


KAPUR NGA NE	29 shtator 2026, 08:07:13 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	29 shtator 2026, 08:04:27 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	c23ba6d380a429d93967a24d455169bfe64c8b31672b0f0ce27a62a07d281468
TEKSTI	fb43fdc9f460ddbbba1c1b986a6b6618d49bd3497609c57538f6e0edbfd1d49c
PAMJA	b043b7f2dc869ecdb69ea980d9521f3cccb28c28aa48941cfcdf19145015350d

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	9aad52d2f16de1ed01e682fdd045a3239ab7982d03e16144872a11242c5d4563
E MËPARSHMJA	—
RRËNJJA MERKLE	00c036a8b9d029228ae2ceb40f7ad3139dd1ddd4285277109f3fa37fa73abd7e
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/9aad52d2f16de1ed01e682fdd045a3239ab7982d03e16144872a11242c5d4563>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Krasniqi: Ndryshimet në ligjin për Specialen nuk e rrëzojnë vetvetiu aktgjykimin



Profesori Kolë Krasniqi ka deklaruar se ndryshimi i Ligjit për Dhomat e Specializuara nuk do të sillte automatikisht ndryshimin e aktgjykimin të 16 shtatorit 2026 dhe as përfundimin e proceseve gjyqësore që po zhvillohen në Hagë.

Sipas tij, çdo ndërhyrje në legjislacion duhet të respektojë Kushtetutën dhe marrëveshjet ndërkombëtare. Në rastin e katër ish-krerëve të UÇK-së, apeli do të vazhdojë të shqyrtohet në Hagë, ndërsa mundësia e transferimit të procedurave në Kosovë do të mund të diskutohet vetëm pasi të merret një vendim i formës së prerë.

Krasniqi ka theksuar se miratimi i ndryshimeve ligjore pa një analizë të plotë juridike mund të hapë mosmarrëveshje të reja institucionale dhe ligjore.

A mund ta arrijë qëllimin e synuar ndryshimi i Ligjit për Dhomat e Specializuara?

Kuvendi i Kosovës ka të drejtë dhe arsye për të shqyrtuar ndryshime në Ligjin nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar. Megjithatë, një ligj i ri nuk do ta ndryshonte vetvetiu aktgjykimin e 16 shtatorit 2026 dhe nuk do t'i ndalte procedurat gjyqësore në Hagë. Pasoja konkrete do të varen nga përmbajtja e dispozitave, përputhshmëria e tyre me Kushtetutën dhe obligimet ndërkombëtare, si dhe nga mënyra se si do të zbatoheshin në çështjet që janë ende në proces.

Sipas raportimeve publike, projektligji i dorëzuar nga PDK-ja synon që juridiksioni i Dhomave të Specializuara të kufizohet vetëm te veprat që lidhen drejtpërdrejt me pretendimet e raportit të Dick Martyt. Për çështjet që nuk do të përfshiheshin në këtë juridiksion të riformuluar, propozohet transferimi i tyre te institucionet gjyqësore të Kosovës, së bashku me dosjet, provat dhe materialet e tjera relevante.

Projektiligji parashikon që proceset që tashmë janë duke u zhvilluar në Hagë të vazhdojnë sipas dispozitave

të fundit /



Krasniqi: Ndryshimet në ligjin për Specialen nuk e rrëzojnë vetvetiu...



Nis gjykimi ndaj ish-policit dhe bashkë të akuzuarit për vrasjen ...



Besfort Zeneli asiston në fitoren 3-1 të Suedisë ndaj Polonisë



LSDM akuzon Mickoskin se po e shet pasurinë kombëtare: ...



Mbiemri pas martesës dhe divorci: Çfarë tregon analiza për çift...



Juventus i ndjek situatën e Calhanoglut dhe shqyrton një...



Tifozët turq kërkojnë shkarkimin e Vincenzo Montellës pas disfatë...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

aktuale deri në marrjen e një vendimi përfundimtar. Për rrjedhojë, edhe procedura e apelit në çështjen e katër ish-udhëheqësve të UÇK-së do të zhvillohej në Hagë. Vetëm pas përfundimit të apelit do të mund të hapej mundësia për trajtimin në Kosovë të hapave të mëtejshëm, përfshirë një rigjykim të mundshëm ose përdorimin e një mjeti të jashtëzakonshëm juridik.

Një zhvillim i tillë nuk do të ndodhte automatikisht. Për këtë arsye, çdo ligj i ri do të duhej të përcaktonte qartë gjykatën kompetente, procedurën e transferimit të çështjes, statusin e vendimeve të mëparshme dhe mënyrën e dorëzimit të dosjeve e provave materiale mbi të cilat janë mbështetur aktgjykimet. Po ashtu, duhet të sqarohej raporti i propozimeve të reja me kompetencat që Ligji aktual nr. 05/L-053 ia jep Panelit të Gjykatës Supreme të Dhomave të Specializuara për shqyrtimin e mjeteve të jashtëzakonshme juridike, përfshirë kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Nisma ligjore propozon gjithashtu një kufi maksimal prej 15 vjetësh burgim, vuajtjen e dënimeve në Kosovë dhe mundësinë që të dënuarit t'i nënshtrohen faljes presidenciale. Këto dispozita ende nuk kanë hyrë në fuqi dhe nuk e ndryshojnë automatikisht dënimin e dhënë në shkallën e parë. Projektligji i është përcjellë Qeverisë për mendim.

Më 28 shtator, Kuvendi miratoi një deklaratë për aktgjykimin. Ky dokument paraqet një qëndrim politik dhe institucional, por nuk e ndryshon ligjin, nuk ua largon kompetencën Dhomave të Specializuara dhe nuk e anulon aktgjykimin. Deklarata dhe projektligji përbëjnë dy veprime të ndara.

Baza juridike e Dhomave të Specializuara nuk kufizohet vetëm te Ligji nr. 05/L-053. Themelimi dhe funksionimi i tyre mbështeten edhe në nenin 162 të Kushtetutës, si dhe në marrëveshjet ndërkombëtare përkatëse, përfshirë marrëveshjet me Bashkimin Evropian dhe Holandën si shtet pritës. Në bazë të nenit 19 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara kanë përparësi ndaj ligjeve të Kosovës. Për këtë arsye, çdo ndryshim duhet të analizohet në raport me këto burime juridike. Kuvendi mund ta ndryshojë ligjin, por kjo kompetencë duhet të ushtrohet brenda kufijve kushtetues dhe ndërkombëtarë.

Në çështjen e katër ish-udhëheqësve të UÇK-së, ky dallim ka rëndësi të veçantë. Nga përshkrimi publik i projektligjit nuk rezulton se apeli do të zhvendosej menjëherë në Kosovë. Kështu, çështja e transferimit të kompetencës do të mund të shtrohej kryesisht pas marrjes së një vendimi të formës së prerë. Një ligj i ri nuk mund ta zëvendësojë vendimin e gjykatës së apelit, ndërsa për kundërshtimin e aktgjykimit të shkallës së parë, apeli mbetet mjeti i vetëm i drejtpërdrejtë juridik.

Sipas vlerësimit tim, Kuvendi duhet ta trajtojë këtë debat me përgjegjësi dhe të sigurojë respektimin e plotë të standardeve për një gjykim të drejtë. Para se të votohet projektligji, duhet të verifikohet me kujdes përputhja e tij me Kushtetutën, marrëveshjet ndërkombëtare dhe të drejtat e palëve në proces. Nëse kjo nuk bëhet, iniciativa mund të sjellë një konflikt të ri juridik e institucional dhe tensione të panevojshme me partnerët strategjikë perëndimorë, pa arritur rezultatin e synuar.

Ky është vlerësimi im dhe jo përfundim se projektligji është i pajustifikuar apo antikushtetues.

Shtuar më 29.09.2026 10:04

Tags: [Kuvendi i Kosoves](#), [Ligji](#), [ndryshimi](#)



Nis gjykimi ndaj ish-policit dhe bashkë të akuzuarit për vrasjen e Sadri Sadriut



Në Prizren sekuestrohen 876 kilogramë duhan dhe 118 mijë cigare të dyshuara...



Gucati: Më 1 tetor pres pjesëmarrje nga të gjitha trevat shqiptare, besoj në...



Spahiu: Autoriteti i Kosovës dhe i UÇK-së u forcua, jo u rrënua nga Specialja



Reagon ashpër Emin Azemi pas skandalit me Viora Hysenin: Tirana po...



Dosja 23" dhe çështja e 23 intelektualëve: a do të sjellin provat përgjegjësi...



Në Prishtinë vijon seanca për sulmin ndaj kanalit "Ibër-Lepenc



Mbyllet tubimi i 13-të në Prishtinë në mbështetje të ish-krerëve të UÇK-së



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...

Kërko

Kryesore

Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kontaktimi | Kushtet e Përdorimit | Privacy Policy | Powered by: orihost.com

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.